ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

Gjatë muajit tetor 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar veprimtarinë e tij në përmbushje të përgjegjësive ligjore për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Veprimtaria e Bordit dhe administratës së ERE-s është përqendruar në shqyrtimin e kërkesave për licencim, monitorimin e tregut, trajtimin e ankesave të konsumatorëve, si dhe bashkëpunimin me institucionet vendase dhe ndërkombëtare. Një pjesë e veprimtarisë i është kushtuar rishikimit dhe përshtatjes së kuadrit rregullator, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", i cili parashikon miratimin e akteve të reja nënligjore dhe përshtatjen e akteve ekzistuese me kërkesat e tij.

Ky numër i Buletinit Informativ paraqet një përmbledhje të vendimmarrjeve dhe aktiviteteve kryesore të ERE-s gjatë muajit tetor 2026. Në të pasqyrohen vendimet e Bordit për licencimin e operatorëve dhe regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, zhvillimet në tregun e energjisë, si dhe veprimtaria për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Një vend të veçantë zënë procedurat për hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara nga ligji nr. 59/2026 dhe në funksion të përafrimit të mëtejshëm me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Buletini përfshin gjithashtu informacion mbi bashkëpunimin institucional dhe pjesëmarrjen e ERE-s në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim informimin e publikut mbi veprimtarinë dhe vendimmarrjen e institucionit.

Për më shumë informacion mbi veprimtarinë e ERE-s, vendimet e Bordit, aktet rregullatore dhe proceset në zhvillim, vizitoni faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë: www.ere.gov.al



Në përmbushje të misionit dhe funksioneve të saj ligjore, ERE vijon angazhimin për garantimin e një kuadri rregullator të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent, duke kontribuar në sigurinë e furnizimit me energji, zhvillimin e konkurrencës dhe integrimin e mëtejshëm të tregut shqiptar të energjisë me tregjet rajonale dhe evropiane.

LICENCIME

VENDIME PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT DHE MODIFIKIMIT TË LICENCAVE

Gjatë muajit tetor 2026, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurave administrative për licencimin e dy shoqërive në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike si dhe për modifikimin e një licence ekzistuese, konkretisht:

"MET INVEST" sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë.

"SHPERDHAZA - ENERGJI" sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Arrëz", me kapacitet të instaluar 1,613 kW, i vendosur në ujërat e lumit Shpërdhazë, në Komunën Kaçinar, Rrethi Mirditë.

"E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës për parkun eolik Markat, Livadhja dhe Lukovë. Modifikimi lidhet me rikonfigurimin e turbinave, përqendrimin e të gjithë kapacitetit të projektit prej 72 MW në një fushë të vetme eolike, si dhe ndryshimin e afateve për ndërtimin dhe vënien në punë të centralit.

Për këto aplikime, në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka publikuar njoftimet përkatëse në shtypin e shkruar, në faqen zyrtare të internetit www.ere.gov.al, si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, me qëllim që palëve të interesuara t'u jepet mundësia të paraqesin objeksionet e tyre përpara marrjes së vendimeve përkatëse për dhënien ose refuzimin e licencave.

Gjithashtu, në kuadër të këtyre procedurave, njoftimet përkatëse u janë përcjellë, sipas rastit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe OST sh.a. dhe cdo pale tjeter te idntifikuar te intersit.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV



Vendime për miratimin e modifikimit të licencave

Modifikimi i licencës së shoqërisë "SPV BLUE 2" sh.p.k.

Bordi i ERE-s miratoi modifikimin e Aneksit A të licencës së shoqërisë "SPV BLUE 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke ndryshuar kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik nga 50 MW në 100 MW.Gjithashtu, Bordi vendosi të njohë dhe të lejojë operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria, me kapacitet energjetik total 300 MW, sipas kushteve të përcaktuara në vendim dhe kuadrit ligjor në fuqi. Vendimi përcakton detyrimin që fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin të mos tejkalojë 100 MW, si dhe detyrimin për paraqitjen pranë ERE-s, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, të aplikimit për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

Vendime për rinovimin e licencave

Gjatë muajit tetor 2026, ERE filloi procedurën administrative dhe më pas miratoi rinovimin, për një afat 5-vjeçar, të licencës së shoqërisë "HYDROPOWER" sh.p.k. për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Vendim për refuzimin e licencimit

Gjatë muajit tetor 2026, Bordi i ERE-s vendosi refuzimin e kërkesës së shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet 78,6 MW AC, me vendndodhje në Bashkinë Libohovë, për shkak të mosdepozitimit të dokumentacionit mjedisor brenda afatit të përcaktuar.

Vendim për shfuqizimin e licencës

Bordi i ERE-s vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 76, datë 07.11.2006, të ndryshuar me vendimin nr. 47, datë 18.04.2008, për licencimin e shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Rehovë", HEC "Treskë 1" dhe HEC "Çarshovë". Vendimmarrja u mbështet në konstatimin se shoqëria nuk zotëron më të drejta pronësie apo përdorimi mbi këto vepra hidroenergjetike, të cilat përbëjnë objektin e licencës së saj. Për rrjedhojë, u vlerësua se nuk ekziston më baza faktike dhe juridike për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar nga ky subjekt.

Vendim unifikues mbi detyrimin e prodhuesve të energjisë elektrike për depozitimin në ERE të dokumentacionit të testimit të veprës

Gjatë muajit tetor 2026, Bordi vendosi unifikimin e afateve për depozitimin në ERE të dokumentacionit të testimit të veprës, duke përcaktuar afatet përkatëse për kategoritë e mëposhtme të subjekteve të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike:

- Brenda 60 ditëve nga fillimi i prodhimit, për subjektet që do të licencohen në vijim, si dhe për subjektet e licencuara që ende nuk kanë filluar prodhimin, në rastet kur ky detyrim nuk është përcaktuar shprehimisht në vendimin e licencimit;
- Deri më 30 nëntor 2026, për subjektet që kanë filluar prodhimin, por nuk kanë depozituar dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar në vendimin e licencimit;
- Deri më 31 dhjetor 2026, për subjektet që kanë filluar prodhimin, por në vendimin e licencimit të tyre nuk është parashikuar shprehimisht detyrimi për depozitimin e këtij dokumentacioni.

Kjo vendimmarrje synon të garantojë zbatimin e njëtrajtshëm të kërkesave rregullatore dhe mbikëqyrjen nga ERE të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga licencimi.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

ERE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Vendime për ndryshim vendimmarrjeje

Gjatë muajit tetor 2026, ERE miratoi ndryshimet e vendimeve të licencimit të shoqërive si vijon:

- "GREEN ENERGY" sh.p.k. dhe "SOLAR HORIZON" sh.p.k., duke përcaktuar datën 30.11.2026 si afat për depozitimin e informacionit të përditësuar mbi strukturën organizative dhe stafin teknik. Mosplotësimi i detyrimit mund të sjellë masa për pezullimin e veprimtarisë së licencuar;
- "3AD ENERGY" sh.p.k., duke shfuqizuar kushtet e përmbushura që lidhen me dokumentacionin kontraktor dhe fillimin e prodhimit të energjisë elektrike;
- "NOVA PROSPECT" sh.p.k., duke shfuqizuar detyrimin për raportimin tremujor lidhur me ndryshimin e vlerës së investimit;
- "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k., duke shfuqizuar kushtin për fillimin e prodhimit brenda afateve kontraktore, pasi shoqëria ka hyrë në operim në muajin shtator 2026.

AUTORIZIME MBI ASETET DHE STRUKTURËN E PRONËSISË

Gjatë muajit tetor 2026, Bordi i ERE-s miratoi kërkesat për dhënien e autorizimeve për transferimin e aseteve, si më poshtë:

Transferim asetesh

- ·Dhënien e autorizimit shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme, nëpërmjet barrësimit të tyre, si garanci për shlyerjen e detyrimeve ndaj "Banka e Parë e Investimeve – Albania" sh.a. dhe First Investment Bank AD, Sofje, Bullgari, ku Agjent i Kredisë është "Banka e Parë e Investimeve – Albania" sh.a.



- ·Dhënien e autorizimit shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse, nëpërmjet barrësimit dhe hipotekimit të tyre, si garanci për përmbushjen e detyrimeve ndaj kredidhënësit "Banka OTP Albania" sh.a.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë përkatëse, bankat financuese dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Barrësim kuotash

- Dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., si garanci për përmbushjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse "Banka OTP Albania" sh.a.
- Dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k., si garanci për përmbushjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse "Banka OTP Albania" sh.a.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë, banka financuese dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndryshim ortaku

Bordi i ERE-s, ka vendosur të japë autorizimin për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë "NRG Power" sh.p.k., nga ortaku i mëparshëm shoqëria "SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A" (SENS), tashmë sipas strukturës së kërkuar për 100% të kuotave të kapitalit te shoqëria "HERON SOCIETE ANONYME ENERGY SERVICES" (HERON ENERGY S.A.).
Vendimi përkatës i është komunikuar shoqërisë.

Mosmarrje në shqyrtim

Bordi i ERE-s ka vendosur të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. për dhënien e autorizimit për vendosjen e aseteve të luajtshme (jo fikse) të saj, si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "Banka OTP Albania" sh.a., pasi asetet e luajtshme nuk janë objekt shqyrtimi nga ana e ERE-s, në bazë të përcaktimeve të rregullores në fuqi.
Të gjitha procedurat e sipërcituara janë trajtuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me qëllim garantimin e transparencës dhe respektimin e kërkesave rregullatore.

Garancitë e origjinës

Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë kërkesat e shoqërive "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k., "Sunny Side Energy" sh.p.k. dhe "POWER ENERGY" sh.p.k. për krijimin e llogarive në Regjistrin Elektronik të Garancive të Origjinës, në kategorinë "Prodhues i energjisë elektrike", si dhe për regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralet fotovoltaike.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

ZHVILLIMET NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE – TË DHËNAT PËR MUAJIN SHTATOR 2026

Gjatë muajit shtator, kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vend iu shtua një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar prej 8.8 MW i cili operohet nga shoqëria "IDI 2005" sh.p.k., i pozicionuar në qarkun Fier. Shoqëria e ushtron aktivitetin në tregun e lirë të energjisë elektrike me çmim të parregulluar.

Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë muajit shtator arriti në 215,026 MWh, duke shënuar një rritje prodhimi prej rreth 18% krahasuar me energjinë elektrike të prodhuar në të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Liqeni i Fierzës, i cili përbën rezervuarin kryesor të Kaskadës së Drinit, e nisi muajin me një nivel prej 272.6 m.m.n.d., ndërsa në fund të muajit niveli u regjistrua në kuotën 267.12 m.m.n.d. Sikurse evidentuar gjatë kësaj periudhe kemi ulje të nivelit në liqenin e Fierzës prej rreth 5.48 metër. Prurjet mesatare mujore rezultuan 50 m3/sek ndërsa rezerva energjitike për kaskadën e Drinit në fund të muajit shtator ishte 431.6 GWh.

Përgjatë këtij muaji shoqëria publike "KESH" sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë. Megjithatë, ashtu sikurse edhe në muajin gusht për shkak të pamjaftueshmërisë së prodhimit vendas për mbulimin e plotë të konsumit të energjisë elektrike në vend, shoqëria publike ka kryer procedura blerjeje energji elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik në sasinë 288,162 MWh me një çmim të mesatarizuar 151.93 Euro/MWh.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin shtator rezultoi 247,769 MWh (import), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 127,436 MWh dhe importit të realizuar në sasinë 375,205 MWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike gjatë muajit shtator 2026 rezultuan në nivelin 10.99%, ndërsa humbjet në sistemin e transmetimit u regjistruan në vlerën 1.96%. Krahasuar me muajin gusht 2026, këta tregues paraqesin një ulje prej 3.52 % për sistemin e shpërndarjes dhe rritje prej 0.1 % për sistemin e transmetimit.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it përgjatë muajit shtator u tregtuan gjithsej 228,856.22 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 88,386.81 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 224,175.91 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 166.95 €/MWh ndërsa në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 4,680.31 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 151.29 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 52, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 38 prej tyre edhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë.



Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit është 6. Në muajin Shtator 2026, ALPEX mirëpriti dy anëtar të rinj në Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë, respektivisht shoqërinë INFINIT POWER SOLUTIONS për Zonën e Ofertimit të Kosovës dhe EU GREEN ENERGY sh.p.k për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë.



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV



Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 08.10.2026, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 279, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin shtator 2026, në nivelin 19.91 lekë/kWh për klientët e lidhur në tensionin 35 kV. Krahasuar me muajin gusht 2026, kur çmimi ishte 18.22 lekë/kWh, çmimi i miratuar për muajin shtator rezulton rreth 9.3% më i lartë. Për klientët e lidhur në tensionin 35 kV, çmimi i FMF-së përcaktohet mbi baza mujore dhe reflekton dinamikën e kostos së blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së klientëve që furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në tregun e lirë. Në strukturën e këtij çmimi, tarifat e përdorimit të rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti që ndikon në luhatjen e tij është kostoja e energjisë së blerë.

Konkretisht, për muajin shtator 2026, çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike rezultoi 15.97 lekë/kWh, kundrejt 14.33 lekë/kWh në muajin gusht. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 11.4%, e cila është reflektuar edhe në çmimin përfundimtar të FMF-së, megjithëse në një masë më të moderuar për shkak të peshës së komponentëve të tjerë të pandryshueshëm në strukturën e çmimit.

Për klientët e lidhur në tensionin 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, sipas vendimit të miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori klientësh sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencën ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

REMIT

Në përputhje me "Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", ERE ka vijuar procesin e përditësimit dhe administrimit të të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri, në kuadër të Regjistrit REMIT.
Regjistri REMIT përbën një instrument të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe integritetit të tregut të energjisë elektrike, duke mundësuar identifikimin dhe evidentimin e pjesëmarrësve që kryejnë transaksione me shumicë, si dhe mbështetjen e proceseve të monitorimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimeve të tregut nga ERE.
Për muajin tetor 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në Regjistrin REMIT është 112. Gjatë këtij muaji janë regjistruar katër subjekte të reja, respektivisht shoqëritë "ENERGO-SAS" sh.p.k., "NEXORA ENERGY" sh.p.k., "BUSHTRICA 2017" sh.p.k. dhe "ELENERGJI" sh.p.k.
Të dhënat e regjistrit vijojnë të përditësohen në mënyrë periodike, në funksion të pasqyrimit sa më të plotë dhe transparent të pjesëmarrësve të regjistruar në tregun me shumicë të energjisë elektrike.
Regjistri REMIT është i publikuar dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të ERE-s, në adresën: remit.ere.gov.al

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2024



Në mbledhjen e datës 20.10.2026, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 291, miratoi çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2024, prej 94.19 Euro/MWh në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Gjatë procesit janë njoftuar palët e interesit për fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike deri në 2 MW për vitin 2024 si dhe janë kryer korrespondencat përkatëse me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë mbi informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat dhe dokumentacionin referues për subjektet që kanë marrë miratimin përfundimtar ose kanë nënshkruar kontratë me MIE gjatë vitit 2024.

Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2024 është kryer në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe duke marrë në konsideratë praktikat e ndjekura në vendet e rajonit, si pjesë e analizës krahasuese.

Mbi miratimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike për periudhën 2023-2027”

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 308, datë 21.11.2025, vendosi “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e Planit 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023-2027”. Në vijim ERE njoftoi shoqërinë OSSH sh.a. mbi fillimin e procedurës dhe kërkoi informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e këtij plani. Gjatë periudhës së shqyrtimit të planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 2023-2027 janë kryer seanca dëgjimore dhe është kërkuar informacion shtesë konform ligjit 59/2026 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 20.10.2026 me vendimin nr. 292, vendosi mbi miratimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 2023-2027.

në rregullimin e energjisë: diversiteti, drejtimi dhe mundësitë e barabarta”, të zhvilluar më 21 tetor 2026, në Milano, Itali.

Monitorimi i gatishmërisë për furnizimin me energji elektrike në zonat bregdetare gjatë sezonit veror 2026

Në mbledhjen e datës 20 tetor 2026, Bordi i ERE-s shqyrtoi informacionin mbi zbatimin e planit të masave për garantimin e furnizimit me energji elektrike në zonat bregdetare gjatë sezonit veror qershor–shtator 2026, bazuar në raportimin e shoqërisë OSSH sh.a.

Nga vlerësimi i informacionit të përcjellë nga OSSH sh.a., rezulton se shoqëria ka ndërmarrë masa teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë dhe vazhdimësisë së furnizimit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të transformimit, rishpërndarjen e ngarkesave, fuqizimin e rrjetit të shpërndarjes dhe krijimin e alternativave të furnizimit në rast avarish.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

Zhvillimi dhe përshtatja e kuadrit rregullator në zbatim të Ligjit nr. 59/2026, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"



Gjatë muajit tetor 2026, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 59/2026 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Grupi i Punësvijoi punën për zhvillimin e kuadrit rregullator në funksion të mbrojtjes dhe informimit të konsumatorëve.Në këtë kuadër, gjatë muajit tetor, filluan procedurat për miratimin e akteve të mëposhtme:

- Metodologjia e përcaktimit të vlerave referuese në rastet kur të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme.
- Rregullore "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike".
- Rregullore "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë".
- Rregullore "Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"
- Rregullore "Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"
- Rregullore "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve".
- Rregullore "Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike".

Përpara miratimit përfundimtar, projektaktet do t'i nënshtrohen procesit të konsultimit me palët e interesuara dhe shoqatat që përfaqësojnë konsumatorët. Komentet, propozimet dhe vërejtjet e paraqitura gjatë konsultimit do të shqyrtohen dhe do të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së versioneve përfundimtare që do t'i paraqiten Bordit për miratim.

Gjithashtu, në këtë kuadër, gjatë muajit tetor, u miratuan aktet si më poshtë vijojnë:

- Rregullore "Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme".
- "Marrëveshja TIP për anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme"

Miratimi i këtyre akteve përcakton kuadrin procedural për krijimin, regjistrimin dhe administrimin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, si dhe rregullat që duhet të zbatohen për anëtarësimin në to. Këto zhvillime krijojnë kushtet për nxitjen e pjesëmarrjes së konsumatorëve në iniciativa të përbashkëta të prodhimit dhe përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme.
Nismat e ndërmarra dhe aktet e miratuara gjatë këtij muaji përfaqësojnë hapa konkretë në zbatimin e Ligjit nr. 59/2026, duke synuar përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit rregullator me kërkesat e reja ligjore, forcimin e të drejtave të konsumatorëve dhe rritjen e transparencës në sektorin e energjisë elektrike.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV



Vendimmarrjet e Bordit të ERE-s gjatë muajit tetor

Gjatë muajit tetor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) zhvilloi 3 mbledhje, për të cilat njoftimet përkatëse u publikuan paraprakisht në faqen zyrtare dhe në kanalet e komunikimit të ERE-s, në përputhje me parimet e transparencës dhe informimit të publikut duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara ndjekjen online të mbledhjeve.

Gjatë këtyre mbledhjeve, Bordi miratoi gjithsej 38 vendime, të cilat trajtuan një gamë të gjerë çështjesh rregullatore, ndër to fillimin e procedurave të licencimit, dhënien, transferimin dhe modifikimin e licencave, miratimin e çmimeve dhe tarifave të rregulluara, si dhe akte të tjera rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për të garantuar informimin në kohë të publikut dhe transparencën e procesit vendimmarrës, pas çdo mbledhjeje u publikua një përmbledhje e vendimeve të miratuara në kanalet zyrtare të komunikimit të ERE-s. Ndërkohë, tekstet e plota të vendimeve janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën "Vendime", si dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



RAPORTIMI I KRYETARIT TË ERE-S NË KUVEND

Më 14 tetor 2026, Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, raportoi në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale të Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e institucionit dhe ecurinë e masave të ndërmarra gjatë vitit 2026.

Raportimi përfshiu një pasqyrë të përmbushjes së rekomandimeve evropiane, zbatimit të Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit të ERE-s, si dhe të zhvillimeve në kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit energjetik. Gjithashtu, u trajtuan çështje që lidhen me monitorimin dhe ecurinë e tregut të energjisë elektrike, integrimin e burimeve të rinovueshme, sigurinë e furnizimit dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Ky raportim mundësoi paraqitjen përpara Kuvendit të ecurisë së veprimtarisë së ERE-s, masave të ndërmarra dhe prioriteteve institucionale në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit të energjisë.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV





PUBLIKIME DHE PËRDITËSIME NË FAQEN E INTERNETIT DHE NË RRJETET SOCIALE

Gjatë muajit tetor 2026, ERE vijoi komunikimin me publikun përmes faqes zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale, duke kombinuar publikimet institucionale me materiale informuese dhe ndërgjegjësuese mbi zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike.

Një ndër rubrikat informuese të publikuara në rrjetet sociale është "Energjia në shifra", përmes së cilës paraqiten në mënyrë periodike treguesit kryesorë të sistemit elektroenergjetik shqiptar. Këto publikime përfshijnë të dhëna mbi prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike, kontributin e burimeve të rinovueshme, pikun e ngarkesës, shkëmbimet e energjisë me vendet fqinje, si dhe çmimet dhe vëllimet e tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX). Në këtë mënyrë, publikut i mundësohet një pasqyrë më e qartë dhe periodike mbi ecurinë e sektorit dhe zhvillimet e tregut të energjisë elektrike.

Paralelisht, në Instagram u publikuan materiale shpjeguese mbi konceptet dhe risitë e prezantuara nga Ligji nr. 59/2026, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", duke trajtuar rolin e ri të konsumatorit në treg, vetëprodhimin, ruajtjen e energjisë, komunitetet e energjisë dhe mundësitë për menaxhimin më efikas të konsumit. Këto materiale synojnë të përcjellin në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme ndryshimet e kuadrit të ri ligjor dhe mundësitë që ai krijon për konsumatorët.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua gjithashtu transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesuara në proceset vendimmarrëse, përmes publikimit të projektakteve në konsultim publik, duke krijuar mundësi për paraqitjen e komenteve, sugjerimeve dhe propozimeve përpara miratimit të tyre nga Bordi i ERE-s.

Gjithashtu, në faqen zyrtare të ERE-s vijojnë të jenë të përditësuara dhe të aksesueshme regjistrat elektronikë dhe informacioni institucional, ku qytetarët, konsumatorët dhe subjektet e interesuara mund të informohen mbi:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës (kliko këtu)
- Ankesa të konsumatorëve (kliko këtu)
- Licencime (kliko këtu)
- Autorizime (kliko këtu)
- Procedurat e autorizimit në proces (kliko këtu)
- Procedurat e licencimit në proces (kliko këtu)
- Projektaktet dhe konsultimet publike në proces. (kliko këtu)

Përmes këtyre formave të komunikimit dhe informimit, ERE synon të lehtësojë aksesin në informacion, të rrisë njohuritë e publikut mbi sektorin e energjisë elektrike dhe të drejtat e konsumatorëve, si dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të palëve të interesuara në proceset rregullatore.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV





BASHKËPUNIMI DHE ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE

ERRA – Athinë, Greqi 26-27 tetor 2026

·Më 26–27 tetor 2026, ERE mori pjesë në aktivitetet e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), të zhvilluara në Athinë, Greqi. Gjatë Asamblesë së Përgjithshme u shqyrtuan dhe miratuan çështje që lidhen me anëtarësimin, strukturën e kuotave të anëtarësisë, si dhe planin e punës dhe buxhetin e shoqatës për vitin 2027. Në vijim, diskutimet u përqendruan në pavarësinë e autoriteteve rregullatore, përdorimin e inteligjencës artificiale, fleksibilitetin e rrjetit, zhvillimet në tregjet e energjisë dhe ndikimin e qendrave të të dhënave në konsumin e energjisë elektrike. Pjesëmarrja e ERE-s kontribuoi në shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet rregullatore homologe.

Workshop MEDREG – Lisbonë, Portugali 30 tetor 2026

·Më 30 tetor 2026, në Lisbonë, Portugali, u zhvillua workshop-i i MEDREG-ut mbi depozitimin e energjisë, në kuadër të aktiviteteve për burimet e rinovueshme të energjisë. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) u përfaqësua nga z. Elton B. Radheshi, Sekretar i Përgjithshëm, i cili prezantoi zhvillimet në Shqipëri lidhur me projektet e depozitimit të energjisë, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e ERE-s në zbatimin e kuadrit ligjor për projektet hibride, projektet e pavarura dhe stacionet e pompimit të energjisë elektrike (pump storage).

Balkan Energy School (BES) 13 tetor 2026

·Më 13 tetor 2026, ERE organizoi Seminarin e 18-të të Balkan Energy School (BES), në kuadër të projektit KEP, me temë "Ensuring Security of Gas Supply" (Siguria e furnizimit me gaz natyror). Seminari u zhvillua me pjesëmarrjen e rregullatorëve, ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve energjetike nga vendet pjesëmarrëse në Shkollën Ballkanike të Energjisë. Diskutimet u përqendruan në sfidat që lidhen me garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me gaz natyror, zhvillimet e tregut dhe koordinimin ndërmjet vendeve të rajonit. Gjithashtu, u trajtuan qasjet rregullatore dhe mundësitë për forcimin e bashkëpunimit në funksion të sigurisë energjetike rajonale.

MEDREG-CEER-ECRB – Milano, Itali 14-15 tetor 2026

·Më 14–15 tetor 2026, në Milano, Itali, u zhvillua Takimi Trepalësh MEDREG-CEER-ECRB dhe Mbledhja e Grupit të Punës për Çështjet e Konsumatorëve të MEDREG-ut, e drejtuar nga znj. Erjola Sadushi, Anëtare e Bordit të ERE-s dhe Kryetare e këtij Grupi. Në këtë cilësi, znj. Sadushi mbajti fjalën përshëndetëse në hapje të aktivitetit dhe drejtoi punimet e mbledhjes, duke udhëhequr diskutimet mbi çështjet prioritare të mbrojtjes së konsumatorëve në sektorin energjetik. Në fokus të takimit ishin fuqizimi dhe mbrojtja e konsumatorëve, përdorimi i inteligjencës artificiale dhe mjeteve digjitale në mbikëqyrjen e tregjeve me pakicë, siguria kibernetike, mbrojtja e të dhënave personale dhe përmirësimi i procedurave për trajtimin e ankesave.

·Gjithashtu, gjatë muajit tetor 2026, ERE vijoi angazhimin në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale, përmes pjesëmarrjes aktive në takimet, seminaret dhe forumet e specializuara të MEDREG-ut, ERRA-s, CEER-it dhe ECRB-së, duke kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave, diskutimin e zhvillimeve të reja rregullatore dhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TETOR 2026

BULETINI INFORMATIV

ZHVILLIME RREGULLATORE

Gjatë muajit tetor 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vijoi ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Veprimtaria e institucionit u përqendrua në trajtimin e çështjeve që lidhen me funksionimin e sektorit, monitorimin e zhvillimeve në tregun e energjisë, transparencën dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, si dhe informimin e publikut mbi zhvillimet kryesore të tij. Në kuadër të monitorimit të tregut të energjisë elektrike, ERE shqyrtoi aspekte që lidhen me faturimin e disbalancave dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike gjatë sezonit veror. Vëmendja u përqendrua në zbatimin e mekanizmave për administrimin e disbalancave, si dhe në vlerësimin e masave të ndërmarra për garantimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit. Këto procese janë pjesë e rëndësishme e monitorimit të funksionimit të tregut dhe të përgjegjësive të operatorëve të sektorit. Gjithashtu, ERE nisi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a. për emërtimin e saj si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Procesi lidhet me vlerësimin e përmbushjes së kërkesave dhe kritereve përkatëse për marrjen e këtij emërtimi, i cili ka rëndësi për ushtrimin e funksioneve të ALPEX-it në organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në vijim të veprimtarisë së monitorimit, ERE shqyrtoi raportimin e OST-së mbi përdorimin e një pjese të rrjetit të fibrës optike për periudhën janar–qershor 2026. Në fokus të shqyrtimit ishte zbatimi i marrëveshjeve për dhënien në përdorim të këtij rrjeti, si dhe respektimi i kushteve të përcaktuara në to, me qëllim sigurimin e administrimit dhe shfrytëzimit efektiv të aseteve të operatorit.

Zhvillimi i teknologjisë dhe rritja e përdorimit të automjeteve elektrike po sjellin ndryshime në sektorin e energjisë elektrike, duke krijuar nevojën për përshtatjen e infrastrukturës dhe të kuadrit rregullator me këto zhvillime. Në këtë kuadër, ERE vijon angazhimin për krijimin e kushteve rregullatore që mbështesin zhvillimin e infrastrukturës së karikimit dhe përdorimin e teknologjive të reja. Ligji nr. 59/2026 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" përbën bazën ligjore për adresimin e këtyre zhvillimeve. Në këtë drejtim, për vitin 2026, ERE ka miratuar çmimet e energjisë elektrike për pikat e karikimit që plotësojnë kriteret përkatëse: 22 lekë/kWh jashtë orarit të pikut dhe 25,3 lekë/kWh në orarin e pikut.

Në vijim të zhvillimeve të tregut, ERE informoi edhe mbi rolin e agregatorëve si pjesëmarrës të rinj në tregun e energjisë elektrike. Agregatori bashkon dhe menaxhon në mënyrë të koordinuar mundësitë e disa pjesëmarrësve të vegjël, si konsumatorët, prodhuesit e vegjël, sistemet e depozitimit dhe konsumin fleksibël. Në këtë mënyrë, burimet e vogla dhe të shpërndara mund të marrin pjesë së bashku në treg, duke kontribuar në rritjen e fleksibilitetit, integrimin e burimeve të rinovueshme dhe përdorimin më efikas të energjisë.

Transparenca në faturimin e energjisë elektrike dhe informimi mbi të drejtat e konsumatorëve vijuan të ishin pjesë e komunikimit publik të ERE-s. Përmes materialeve informuese u shpjeguan elementet përbërëse të faturës, informacioni që ajo duhet të përmbajë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve në marrëdhënien me furnizuesin. Gjithashtu, vijoi informimi i konsumatorëve mbi procedurat e paraqitjes dhe trajtimit të ankesave, duke sqaruar mënyrën e ndjekjes së tyre, dokumentacionin përkatës dhe hapat që duhet të ndërmarrin për adresimin e problematikave që lidhen me furnizimin me energji elektrike. Në këtë kuadër, u theksua rëndësia e njohjes së këtyre procedurave dhe e të drejtave të konsumatorëve, për lehtësimin e komunikimit me furnizuesin dhe trajtimin efektiv të ankesave.

Në kuadër të transparencës dhe pjesëmarrjes publike, ERE vijoi informimin e palëve të interesuara mbi aktet rregullatore në proces konsultimi, duke i ftuar të njihen me dokumentet përkatëse dhe të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afateve të përcaktuara. Konsultimi publik është pjesë e rëndësishme e procesit të hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore, i cili përfshin analizën dhe përgatitjen e projektaktit, konsultimin me palët e interesuara, shqyrtimin e komenteve nga Bordi i ERE-s dhe, pas marrjes së vendimit, publikimin dhe zbatimin e aktit. Ky proces synon të sigurojë transparencë, gjithëpërfshirje dhe vendimmarrje në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në funksion të transparencës së tregut, ERE vijoi publikimin dhe përpunimin e treguesve të sektorit përmes materialeve "Energjia në shifra", të cilat pasqyrojnë të dhëna mbi prodhimin, konsumin dhe tregues të tjerë të rëndësishëm të tregut të energjisë elektrike, duke ofruar një pasqyrë më të qartë mbi zhvillimet e sektorit. Gjatë muajit tetor, vijoi gjithashtu shqyrtimi i çështjeve që lidhen me licencimin, modifikimin dhe rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, si dhe me zhvillimin e kapaciteteve të reja të prodhimit nga burimet e rinovueshme.

Për më shumë informacion:

Ftojmë të gjithë qytetarët, operatorët e tregut dhe palët e interesuara të vizitojnë faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë për të aksesuar vendimet e Bordit, aktet rregullatore, dokumentet në konsultim publik, raportet, tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, si dhe të gjitha publikimet më të fundit të institucionit.

Faqja zyrtare: www.ere.gov.al

Nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit në Facebook, Instagram dhe LinkedIn, ERE vijoi të përcjellë informacion mbi aktivitetin institucional, vendimmarrjet e Bordit, zhvillimet në sektorin e energjisë, proceset rregullatore dhe njoftimet me interes për konsumatorët, operatorët e tregut dhe palët e tjera të interesuara. Komunikimi në rrjetet sociale vijoi të shërbejë si një instrument plotësues për rritjen e aksesueshmërisë së informacionit dhe për informimin në kohë të publikut mbi veprimtarinë e institucionit.